# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-454753**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Burri i ish-drejtoreshës hajdute të Postës Durrës promovohet në Bashki |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392466.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 10:54:58 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 18 shtator 2026, 10:52:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 18 shtator 2026, 10:51:00 UTC → 18 shtator 2026, 10:53:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bb1da588427139d60b1b6799bcc478df2b661e256920599f91c752c239990edd` |
| TEKSTI | `b841f2ae61f9fabd938304d38d3b440742c921a7b781093b42b30a7f3bc1b693` |
| PAMJA | `08314a8203d64df92c441476845a54541c8903b24efad34d0439fb3c83041fba` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9d1bd02ee6613dc632285662af81bfe865cc1e1b76472bd430817b3d7654b89d` |
| E MËPARSHMJA | `937a73b2ecebe48e032c98ee5c4f6e7960cae45fb5c51ab27ac8bae6ad9c9077` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9d1bd02ee6613dc632285662af81bfe865cc1e1b76472bd430817b3d7654b89d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Burri i ish-drejtoreshës hajdute të Postës Durrës promovohet në Bashki

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 18.09.2026, 12:52

Share Share



Vetëm dy muaj pasi ish-drejtoresha e Postës së Durrësit, Elisabeta Mataj, u arrestua dhe u la në burg nën dyshimin se përvetësoi mbi 700 mijë euro të destinuara për pagesat e pensioneve, bashkëshorti i saj, Fetah Mataj, është promovuar në një pozicion drejtues në Bashkinë e Durrësit. Sipas burimeve të cituara nga *Shqiptarja.com*, Mataj, i cili prej vitesh punonte në sektorin komunal të qytetit, është emëruar së fundmi Përgjegjës për Evadimin e Mbetjeve Urbane.

Emërimi i tij vjen pak kohë pas skandalit në Postën e Durrësit, ku bashkëshortja e tij po hetohet për përvetësimin e një shume të konsiderueshme parash. Sipas hetimeve, Elisabeta Mataj, ish-shefja e financës Valbona Duni dhe arkëtarja Paola Dana dyshohet se kanë përvetësuar rreth 700 mijë euro, të cilat ishin destinuar për pensionet në Krujë dhe Shijak. Kamerat e sigurisë thuhet se kanë dokumentuar 11 raste kur thasët me para dërgoheshin në zyrën e ish-drejtoreshës, ndërsa në sistem fondet figuronin si të transferuara drejt dy degëve postare.

Ndërkohë, Prokuroria po vijon hetimet për të zbardhur të gjithë skemën dhe destinacionin e parave të përvetësuara. Një nga pistat që po verifikohet është edhe dyshimi se një pjesë e shumës mund të jetë shpenzuar në kazino. Promovimi i bashkëshortit të ish-drejtoreshës në një pozicion drejtues në bashki, vetëm pak javë pas arrestimit të saj, ka ngritur pikëpyetje mbi mënyrën dhe kriteret e këtij emërimi.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.